

Plagosi dy gra, gjuajti policinë, qëlloi veten me armë: Zbardhet raporti për rastin në Fushë Kosovë

LAJME



29/01/2023 08:57



Policia e Kosovës me anë të raportit 24 orësh ka treguar edhe njëherë kronologjinë e rastit të djeshëm në Fushë Kosovë, që si bilanc pati 2 gra të plagosura e një burrë të vrarë.

Policia në raport thotë se dy viktimat femra kosovare për shkaqe ende të panjohura janë qëlluar dhe plagosur me armë zjarri nga i dyshuari mashkull kosovar i cili gjendej në arrati, transmeton [lajmi.net](#).

Viktimat për tretman mjekësor janë dërguar në QKUK.

Më vonë është pranuar informata për vendndodhjen e të dyshuarit ku zyrtarët policorë e kanë urdhëruar të dyshuarin që të dorëzohet, mirëpo i njëjti ka shtënë me armë në drejtim të zyrtarëve policorë.

Gjatë shkëmbimit të zjarrit me policinë i dyshuari dyshohet se ka qëlluar veten dhe i njëjti ka ndërruar jetë.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitë relevante policore si dhe është njoftuar Inspektorati Policor.

Të gjitha veprimet e nevojshme hetimore janë duke u marrë në koordinim me prokurorin e shtetit. [/Lajmi.net/](#)

Artikuj të ngjashëm



January 29, 2023

Memli Krasniqi udhëton sërish drejt SHBA-ve



January 29, 2023

Petrish: Kurti s'mund ta refuzojë Asociacionin, BE do sukses këtë vit...



January 29, 2023

Tanket "Leopard": Çka përfiton Ukraina, çka rrezikon Perëndimi?



January 29, 2023

Haradinaj kujton të rënët në Rogovë të Hasit: Rënia e tyre...



January 29, 2023

Postimi për ish-këshilltarin e Kurtit vazhdon t'i sjellë Krasniqit probleme në...



January 29, 2023

Analistët: Për shmangien e zgjedhjeve të parakohshme duhet të dëgjohen ndërkombëtarët...

LAJME TË FUNDIT



Formacionet zyrtare:
Milan – Sassuolo



Memli Krasniqi
udhëton sërish drejt
SHBA-ve



Shqetësime në kampin
e Barcelonës, Dembele
jashtë fushës për pesë
javë



Petrish: Kurti s'mund
ta refuzojë
Asociacionin, BE do...

Other Links

[Fact-Checking Policy](#)
[Ethics Policy](#)
[Corrections Policy](#)
[Ownership & Funding Information](#)
[Editorial Team Information](#)